**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

# V E N D I M

Nr. 02, datë 17/02/2005

## "MBI SHITBLERJEN PËR EFEKT LEGALIZIMI TË TRUALLIT SHTETËROR TË ZËNË ME NDËRTIM SHTËSË TEJ LEJES SË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.48, DT.21/07/2001 TË KRRT-SË SË BASHKISË SË TIRANËS"

Mbështetur ne ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, gërma "e", ligjit Nr.9209, dt.23/03/2004 "Për legalizimin e shtesave në ndërtime" neni 2, pika 11 dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

## V E N D O S I;

1. Të miratojë shitjen e sipërfaqes së truallit prej 1310 (një mijë e treqind e dhjetë) m2 Shoqërisë "Taiwan" sh.p.k, pasuria Nr.7/187, zona kadastrale 8380 ndodhur në rrugën "Dëshmorët e 4 Shkurtit", sipas genplanit bashkëlidhur.

2. Çmimi i shitjes dhënë nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tirana 1, është 12000 (dymbëdhjetë mijë) lekë për m2.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës dhe Drejtoria e Legalizim Shpronësimeve për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**